

REPUBLIKA E SHQIPERISE
QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 20 Prot.

Datë, 17 07 .2017

VENDIM

Bazuar në ligjin Nr. 8485, dt. 12.5.1999 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe nenit 131 të ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 361, dt. 11.07.2017, urdhërin e Drejtorit të Qendrës së Studimeve Albanologjike Nr.1, dt.14.07.2017, Vendimin e Senatit Akademik të Qendrës së Studimeve Albanologjike Nr.1, dt. 17.07.2017 dhe Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në insitucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", sot më dt. 19.07.2017 u mbledhën anëtarët e KIZ :

Z.Ferid Hudhri IAKSA

Z. Sali Kadria Instituti i Historisë

Z. Ilasan Bello Instituti i Historisë

Znj. Rafaela Marteta Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë

Z. Elio Hobdari Instituti i Arkeologjisë

Znj. Sabina Dhrimo në cilësinë e Sekretares

Komisioni pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e paraqitura nga drejtorët e instituteve, ku janë deklaruar vendndodhjet e KZI-ve

VENDOSI:

1. Vendndodhja e KZI-së së Institutit të Arkeologjisë të jetë salla e Bibliotekës së këtij instituti.
2. Vendndodhja e qendrës së numërimit të votave të jetë përsëri Biblioteka e Institutit të Arkeologjisë
3. Vendndodhja e qendrës së votimit të jetë salla e pavijonit të prehistorisë, pranë Muzeut Arkeologjik, Tiranë.
4. Vendndodhja e KZI-së së Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë të jetë pranë ish-zyrës së drejtorit të këtij instituti, në godinën e IAKSA-s. Po në këtë mjedis të kryhet edhe procesi zgjedhor. Po këtu të kryhet edhe procesi i numërimit të votave.
5. Vendndodhja e KZI-së së Institutit të AKSA dhe qendra e votimit për këtë institut të jetë zyra e drejtorisë së IAKSA.

6. Numërimi i votave të LAKSA të bëhet në sallën e koordinatorit pranë drejtorisë së LAKSA, po në të njëjtën godinë, kati II.
7. Vendndodhja e KZI-së së Institutit të Historisë të përcaktohet nga vetë KZI e institutit.

KRYETARI

Sali Kadria

Ferid Hudhri
Hasan Bello



Elio Hobdari
Rafaela Marteta

Sabina Dhrimo